



Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Tiranë / /2016

TIRANE

Në përfundim të shqyrtimit të çështjes, me Vendimin nr.10508, datë 23.07.2007, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, ka konstatuar cënimin e së drejtës për

zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosekzekutimit në një afat të arsyeshëm të Vendimit nr.502, datë 06.03.2003, të dhënë nga Gjykata e Lartë.

Për të mundësuar ekzekutimin e Vendimit nr.502, datë 06.03.2003, të dhënë nga Gjykata e Lartë, rezulton se, Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Vlorë, ka lëshuar urdhërin e ekzekutimit datë 14.04.2004, dhe se ankuesi po në këtë vit ka kërkuar vënien në ekzekutim të tij pranë Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor.

Edhe pse Vendimi nr.502, datë 06.03.2003, i Gjykatës së Lartë, ka vendosur vetëm për formalizimin e Vendimit nr.109, datë 27.09.1996 të KKKP, Rrethi Vlorë, më datë 29.05.2006, Komisioni i Kthimit dhe Kompesimit të Pronave, Vlorë, në kundërshtim me urdhërimin e dhënë nga Gjykata e Lartë, sipas Vendimit nr.502, datë 06.03.2004, ka vendosur për mos shqyrtimin e rastit dhe dërgimin e çështjes për rivlerësim në Komitetin Kombëtar të Kthimit dhe Kompesimit të Pronave. Më 5 Prill 2007, Komiteti Kombëtar, i njohur si Agjencia Shtetërore e Kthimit dhe Kompesimit të Pronave, informoi ankuesit, se, pavarësisht se dosja e Komisionit në fakt ishte plotësuar, vendosi pezullimin e procedurave derisa Qeveria të realizojë planet e duhura për vlerësimin e pronës.

Pretendimet e ankuesit për shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, miratuar me ligjin nr.8137, datë 31.07.1996, e cila parashikon se :

"Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur, e paanshme, e krijuar ligjërisht..., e cila do të vendosë qoftë për mosmarrëveshjet mbi të drejtat dhe detyrimet e tij me karakter civil,...",

sa i takon mosekzekutimit të Vendimit nr. 502, datë 06.03.2003, të Gjykatës së Lartë dhe tejzgjatjes së procedurave civile, janë vlerësuar të drejta prej Gjykatës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, me rastin e dhënies së Vendimit nr.10508, dt.23.07.2007.

Në vendimmarrjen në fjalë, GJEDNJ, ka konsideruar qëndrimin e mbajtur prej autoriteteve të ngarkuara me ligj për ekzekutimin e Vendimit nr.502, datë 06.03.2003, të dhënë nga Gjykata e Lartë, në cënim të së drejtës të pronësisë si dhe parimit për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, sikundër parashikuar në :

A.Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë,

Neni 41

1. E drejta e pronës private është e garantuar.
2. Prona fitohet me dhurim, me trashëgimi, me blerje dhe me çdo mënyrë tjetër klasike të parashikuar në Kodin Civil.
3. Ligji mund të parashikojë shpronësime ose kufizime në ushtrimin e së drejtës së pronës vetëm për interesa publike.

4. Shpronësimet ose ato kufizime të së drejtës së pronës që barazohen me shpronësimin, lejohen vetëm përkundrejt një shpërblimi të drejtë.

5. Për mosmarrëveshjet lidhur me masën e shpërblimit mund të bëhet ankim në gjykatë.

Neni 42/2

Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetuese dhe ligjore ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj."

Neni 142/3

Organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore.

Neni 131

Gjykata Kushtetuese vendos për : f) gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave.

Neni 181

1. Kuvendi, brenda dy deri tre vjetëve nga hyrja në fuqi e kësaj Kushtetute, nxjerr ligje për rregullimin e drejtë të çështjeve të ndryshme që lidhen me shpronësimet dhe konfiskimet e kryera para miratimit të kësaj Kushtetute, duke u udhëhequr nga kriteret e nenit 41.

2. Ligjet dhe aktet e tjera normative të miratuara para datës së hyrjes në fuqi të kësaj Kushtetute dhe që kanë të bëjnë me shpronësimet dhe konfiskimet, do të zbatohen kur nuk vijnë në kundërshtim me të.

B.Konvetën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut

Neni 6§ 1

"Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur, e paanshme, e krijuar ligjërisht..., e cila do të vendosë qoftë për mosmarrëveshjet mbi të drejtat dhe detyrimet e tij me karakter civil,...".

Pretendimet e ankuesit për mosekzekutimin e vendimit gjyqësor civil të formës së prerë nr. 502, datë 06.03.2003, të dhënë prej Gjykatës së Lartë, janë gjetur të drejta prej GJEDNJ, në kuptim të nenit 35 § 3 të Konventës, me rastin e shqyrtimit të ankesës së kryer prej Familjes B. GJEDNJ në vendimmarrjen nr.10508, dt.23.07.2007, ka ritheksuar se;

"Ekzekutimi i vendimit gjyqësor i dhënë nga një gjykatë, duhet të konsiderohet si pjesë përbërëse e "procesit gjyqësor" sipas qëllimit të nenit 6. Vonesat në ekzekutimin e

vendimit gjyqësor mund të justifikohen në rrethana të caktuara, por nuk duhet të jenë të tilla që të dëmtojnë thelbin e së drejtës që garanton neni 6 § 1”.

Më tej, GJEDNJ, vlerëson se, çështja nuk demonstroi asnjë justifikim për mosëkzekutimin e Vendimit të datës 6 mars 2003, të Gjykatës së Lartë, prandaj, nga kjo pikëpamje, ka pasur shkelje të nenit 6 § 1, 13, nenit 1 të protokollit nr.1 të Konventës. GJEDNJ, vlerëson se, pala shqiptare duhet të sigurojë, nëpërmjet mjeteve të përshtatshme dhe me shpejtësi, ekzekutimin e vendimit përfundimtar të gjykatës vendase.

Për shkak të mosrespektimit të detyrimit të vendosur, GJEDNJ, sipas Vendimit nr. 10508, dt.23.07.2007, ka vendosur dhe detyrimin e Shtetit Shqiptar të paguaj penalitete në shuma të caktuara në të holla.

Edhe pse ankuesi G.B, ka kërkuar dhe kërkon përmbushjen e detyrimit nga ana e ish-AKKP-së(sot-ATP) të nxjerrë vendim në formën e kërkuar nga ligji, lidhur me kërkesën për kthimin e një sipërfaqe trualli të ndodhur në Vlorë, pa shkak, konstatohet se, organi që ju përfaqësoni nuk ka përmbushur detyrimin ligjor të vendosur sipas Vendimit Gjyqësor civil të formës së prerë nr.502, datë 06.03.2003, dhënë prej Gjykatës së Lartë.

Qëndrimin e derisotëm i mbajtur prej organit që ju përfaqësoni, e kemi konsideruar dhe konsiderojmë si mungesë vullnetit për ekzekutimin e detyrimit të vendosur sipas vendimit gjyqësor në fjalë, i cili është mbështetur dhe prej GJEDNJ me rastin e dhënies së Vendimit nr. 10508, dt.23.07.2007.

Pretendimi i shprehur në shkresën nr.3224/1, datë 13.07.2011, drejtuar Avokatit të Popullit, prej ish-AKKP(sot ATP), se, Vendimi nr.502, datë 06.03.2003, i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si dhe Vendimi i GJEDNJ nr.10508/02, datë 23 Tetor 2007, janë ekzekutuar me rastin e dhënies së Vendimeve nr. 414 dhe nr.415, datë 22.04.2008, sipas të cilave është vendosur : “... **të mos njohë të drejtën e pronësisë subjektit të shpronësuar...**”, nuk mund të vlerësohet në përputhje me ligjet në fuqi. Objekti i detyrimit të vendosur nga Gjykata e Lartë me Vendimin nr.502, datë 06.03.2003, ka qenë dhe mbetet dhënia e formës së kërkuar nga ligji i Vendimit nr.109, datë 27.09.1996, të dhënë nga ish AKKP(sot - ATP), dhe jo rishqyrtimi në themel i kërkesës së Familjes B për njohjen me të drejtë kthimi apo kompesimi të pasurisë së paluajtshme, sikurse ka ndodhur me rastin e dhënies së vendimeve nr.414 dhe nr.415, datë 22.04.2008, të cilat në kuptim dhe zbatim të parashikimeve të ligjit nr. 9235, datë 29.07.2004 “*Për kthimin dhe kompesimin e pronës*”, të ndryshuar, K.Pr.A., konsiderohen të pavlefshme, për shkak se;

1. Ish-AKKP(sot ATP) ka zhvilluar procedurë administrative për rishqyrtimin e kërkesës së Familjes B, për njohjen e një prone me të drejtë kthimi apo kompesimi, ndërkohë që ky organ, ish-KKKP, Rrehti Vlorë, është shprehur për këtë kërkesë me Vendimin nr.109, datë 27.09.1996, i cili ka marrë formë të prerë, dhe është në fuqi dhe sot e kësaj dite.
2. Ish-AKKP(sot ATP) ka zhvilluar procedurë administrative në shkelje të parimit të “Gjësë së gjykuar”, për faktin se, ky organ, ish-KKKP, Rrehti Vlorë, është shprehur me Vendimin nr.109, datë 27.09.1996, për kërkesën

e Familjes B., për rrjedhoj, riprocedimi i kryer pa shkak dhe marrja e vendimeve nr. 414 dhe nr.415, datë 22.04.2008, është absolutisht i pavlefshëm

3. Ish-AKKP(sot ATP) në kushtet e mungesës së kërkesës së Familjes B. për rishikimin apo revokimin e Vendimit nr.109/1996 të dhënë prej ish-KKKPronave, Rrethi Vlorë, nuk mund dhe nuk duhej të shprehej me vendimet nr. 414 dhe nr.415, datë 22.04.2008.
4. Ish-AKKP(sot ATP) ka pasur dhe ka detyrimin e nxjerrjes së vendimit për njohjen e pronës me të drejtë kthimi/kompesimi në favor të Familjes B në formën e kërkuar nga ligji, sikurse vendosur nga Gjykata e Lartë, me Vendimin nr.502, datë 06.03.2003. Pra, ish AKKP(sot ATP) në mënyrë të kushtëzuar, duhet të nxjerr aktin(vendimin) për njohjen e pronës me të drejtë kthimi/kompesimi në favor të Familjes B. lidhur vetëm me formën e tij, dhe jo për themelin e kërkesës, sikurse ka ndodhur me rastin e dhënies së vendimeve nr. 414 dhe nr.415, datë 22.04.2008, prej ish-AKKP(sot ATP).

Në kushtet kur qëndrimi i organit që ju përfaqësoni, zj.Drejtoresh e Përgjithshme, është gjetur në cënim të parimeve kushtetuese si më sipër bërë të ditur apo parashikimeve të Konvetës Evropiane për Mbrotjtjen e të Drejtave të Njeriut, bënë të domosdoshme marrjen e masave të menjëhershme nga ana juaj për respektimin e së drejtës të shkelur ankuesit.

Për të mundësuar rivendosjen në vend të së drejtës të shkelur ankuesit, Institucioni i Avokatit të Popullit, mbështetur në parashikimet e nenit 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në të cilin sanksionohet se : “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga Administrata publike”, si dhe nenin 21/b, se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen”.

REKOMANDON

Marrjen e masave të menjëhershme për nxjerrjen e aktit për konstatimin absolutisht të pavlefshëm të vendimeve nr. 414 dhe nr.415, datë 22.04.2008, të dhëna prej ish-AKKP(sot ATP).

Marrjen e masave të menjëhershme për përmbushjen e detyrimit të vendosur sipas Vendimit Gjyqësor civil të formës së prerë nr.502, datë 06.03.2003, të dhënë nga Gjykata e Lartë.

Lidhur me shqyrtimin që do të kryhet rekomandimit të dhënë, konform nenit 22 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, kthimi i përgjigjes të mundësohet bëhet brenda 30 ditëve nga data e dërgimit të kësaj shkrese.

KOMISIONERI
Arben SHKEMBI

Konceptoi dhe Daktilografoi
A.Gjoleka

Vendimet e sipërcituara nuk janë ekzekutim i vendimit të Gjykatës të Lartë dhe as i vendimit të Gjykatës së Strasburgut. Me to, faktikisht është rrëzuar një Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në Strasburg për familjen Boçari, si dhe vendimi administrativ nr.109, datë 27.09.1996 i ish-KKKP-së Vlorë.

Në pjesën arsyetuese të vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr 502, datë 6.3.2003, nënvizohet, se : **“...KKK e Pronave Vlorë ka nxjerrë aktin administrativ, vendimin nr.109, datë 27.09.1996, me të cilin i njihet dhe i kthehet trashëgimlënësve të paditësit Gëzim Boçari një sipërfaqe toke-truall me sipërfaqe 6 100 m² në vendin e quajtur “Uji i Ftohtë”, Vlorë (Jonufër). Vendimi i sipërm i KKK të Pronave është një akt administrativ, të cilit i mungon forma, ka mungesë të nënshkruesve të anëtarëve të të komisionit, etj. Me padinë objekt shqyrtimi kërkon nga KKK të Pronave Vlorë dhënien e formës ligjore të vendimit, duke ju përgjigjur kërkesave së tij drejtuar KKK të Pronave, për pronën objekt kërkimi.....Vendimi i Gjykatës së Rrethit dhe e Apelit që ka rrëzuar padinë e paraqitur nga Gëzim Boçari, janë në zbatim të keq të dispozitave të KPr.Civile që parashkojnë gjykimin e mosmarrëveshjeve Administrative...nuk janë zbatuar dispozitat ligjore të Kodit të Proçedurës Administrative që bëjnë fjalë për aktet administrative, formën e tyre, qëllimin e aktit, arsyetimin e tij, nenet 105, 106 e vijues. Këto dispozita janë të detyrueshme për tu zbatuar nga organi administrativ, që nxjerr aktin administrativ dhe vërteton përfundimin e proçedimit administrativ, i cili sipas nenit 99 të Kodit të Proçedurave Administrative përfundon me marrjen e vendimit nga organi përkates... Sa më sipër, kolegji çmon se me të drejtë pala paditëse i është drejtuar gjykatës për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, meqënëse nuk ka mundur të realizojë të drejtat e tij në rrugë administrative. Sipas nenit 339 të K.Pr.Civile e neneve 105, 106, etj, të Kodit të Proçedurave Administrative, organet e adminstratës të caktuara me ligj për nxjerrjen e vendimeve sipas ligjit nr. 7698, datë 15.04.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave..” janë të detyruar të nxjerrin vendim në formën e kërkuar nga ligji, në lidhje me kërkesën e paditësit Gëzim Boçari, për padinë objekt kërkimi”.**

Vendimet e AKKP-së Tiranë nr. 414 dhe nr. 415 dt 22.04.2008, me të cilat ka vendosur: **“...të mos njohë të drejtën e pronësisë subjektit të shpronësuar...”**

e lexojne dhe interpretojnë krejtësisht gabim vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë me nr 502, dt 6.3.2003, duke i ndryshuar thelbin dhe përmbajtjen e tij.

Institucioni i Avokatit të Popullit, nisur nga vlerësimi në tërësi i rastit dhe pas shqyrtimit të dokumentacionit, nisur nga parimi i zbatimit të ligjshmërisë në proçesin e ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, si dhe për zgjidhje ligjore të rastit konkret, e çmon me vend të bëjë

këtë rekomandim për marrjen e masave të menjëhershme për ekzekutimin përfundimtar të vendimi gjyqësor të trajtuar më lart.

Për këto arsye ligjore, në përputhje me Nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku përcaktohet, se : *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga administrata publike”*, si dhe Nenit 21/b të Ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen”*.

R E K O M A N O J M E

Ekzekutimin e Vendimit nr.10508/02, 23.10.2007 të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në Strasburg, në favor të ankuesit : familja Boçari.

Mbi masat e marra dhe për qëndrimin Tuaj ndaj zbatimit të rekomandimit, lutemi të ktheni përgjigje në respektim të afatit ligjor, brënda 30 ditëve nga data e dërgimit.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin Tuaj ,